



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

PKR.nr.156/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, sipas Kryetarit të Trupit Gjykses Kreshnik Radoniqi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shpresa Kërnja, në lëndën penale kundër të pandehurit Xh. I. nga Klina, për shkak të veprës penale *mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për krime të rënda, PP.I.155/16 të datë 22.07.2016, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 22.08.2016, në praninë e Prokurorit të Shtetit Agim Kurmehaj dhe të pandehurit Xh. I., me datë 22.08.2016 murr dhe publikisht shpalli, dhe me datë 24.08.2016 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **Xh. I.** i lindur me datë në fshatin, Komuna, i biri i Xh. dhe H. gjinisë Z., me numër personal, jeton në K rruga “I G” pn, ka të kryer shkollën, gjendjes së ... ekonomike, më parë i padënuar nga gjykata, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 15.03.2016, rreth orës 18:45, në K në rrugën “I G”, pa autorizim të organeve kompetente ka mbajtur në pronësi armës dhe atë – pushkën automatike AK47, e prodhimit shqiptar, me numër serik, në atë mënyrë që pasi patrulla policore shkon në shtëpinë e të pandehurit meqë kishin pranuar informatë se ka të shtëna me armë zjarri aty, i pandehuri pranon se me rastin e martesës së djalit të tij, kishte shtënë me armën në fjalë, me ç’rast edhe i konfiskohet,

- me çka ka kryer veprë penale *mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 8 par. 1, 9, 10 par. 1, 17 par. 1, 21 par. 1 dhe 2, 41, 42, par. 1 nën par. 1.1, 46, 73, 74 dhe 374 par. 1 të KPRK-së, dhe nenit 245, 246, 248 par 1 dhe 4, 359, 360, 361, 365, 366, 453 par. 4 të KPPRK-se, të pandehurin e

GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 20 (njëzetë) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.

I pandehuri lirohet nga pagimi i shpenzimeve të paushallit gjyqësor.

Ndaj të pandehurit **Xh I** në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, shqiptohet

DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDIT/KONFISKIMI

KONFISKOHET arma e zjarrit – pushkën automatike AK47, e prodhimit shqiptar, me nr serik 040525-87, e sekuestruar sipas vërtetimit mbi konfiskimin e armës të Policisë së Kosovës Stacioni Policor Klinë, me numër të rastit 2016-DE-248 i datës 15.05.2016, dhe **URDHËROHET** që armët e konfiskuara të shkatërrohen pas kryerjes së ekspertizës balistike të urdhëruar me urdhëresën e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.155/2016 të datës 01.06.2016.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP.I.155/16 të datë 22.07.2016, ndaj të pandehurit Xh. I. nga K, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me datë 22.08.2016 në praninë e Prokurorit të Shtetit dhe të pandehurit Xh I.

Me ngritjen e aktakuzës dhe parashtrimin të saj me datë 18.07.2016, gjykatës i është parashtruar edhe Marrëveshja për pranimin e fajësisë e lidhur në mes të Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda e përfaqësuar nga prokurorja Sahide Gashi në njërin anë, dhe i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, avokati Sh. G.në anën tjetër. Meqenëse në seancë nuk prezantoi avokati mbrojtës i të pandehurit, i njëjti deklaroi se nuk mbetet pranë Marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe kërkoj që çështja të procedohet në mënyrë të rregullt pran gjykatës, kur edhe do të deklarohet për fajësinë. Prokurori i shtetit nuk e kundërshtoi propozimin e të pandehurit.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit i pandehuri u deklarua fajtor për veprën penale me të cilën akuzohet.

Pas deklarimit të të pandehurit dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par. 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 4 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit Xh. I. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale *mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata ka vlerësuar sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe gjendjen e vështirë ekonomike. Po ashtu sipas shkresave të lëndës nuk figuron se i njëjti ka qenë i gjykuar nga gjykata në të kaluarën për ndonjë vepër penale. Si rrethana rënduese për të pandehurin gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata në kuptim të nenit 73 të KPRK-se të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPPRK-se.

Duke u bazuar në nenin 453 par.4 të KPPRK-se, gjykata të pandehurin e liron nga pagimi i shpenzimeve procedurale, meqenëse i njëjti është pensionist dhe mbajtës i familjes e kjo do ta rëndonte gjendjen e tyre materiale.

Ndaj të pandehurit Xh. I. në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, është shqiptuar edhe dënimi plotësues i marrjes së sendit, respektivisht konfiskimi i armës – pushkën automatike AK47, e prodhimit shqiptar, me numër serik, duke pas parasysh se arma i nënshtrohet konfiskimit të detyrueshëm sipas nenit 374 par. 3 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.156/16 më datë 22.08.2016

Sekretarja Juridike

Kryetari i Trupit Gjykes

Shpresa Kërnja

Kreshnik Radoniqi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.